

## **AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES**

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 për rregullimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Për qëllim të zbatimit të nenit 65 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

### **Rregulli 29 mbi Shitjen e Sigurimeve Përmes Internetit**

#### **Neni 1**

##### **1. Fushëveprimi i Rregullit**

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja.

##### **2. Autoriteti Ligjor**

Ky rregull implementon nenin 65, të kapitullit VI (Praktika e Tregut dhe Mbrojtja e Klientit) të rregullores së sigurimeve.

##### **3. Definicionet**

Në këtë rregull, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Plani i biznesit” i referohet një strukture të dokumenteve të përbëra nga dhe që përshkruajn mënyrën e propozuar të biznesit të internetit apo aktivitetit në afrimin apo shitjen e produkteve dhe shërbimet e kompanisë, është të mirren masa nga kompania në mënyrë që të pajtohet me termet dhe kushtet e përshkruara në këtë rregull dhe direktivat e BPK-së.

“Bordi i drejtorëve” nënkupton nivelin më të lartë të trupit udhëheqës të një korporate të përbërë nga anëtarët e zgjedhur nga votat e aksionareve. Në këtë rregull, termi “bordi i drejtorëve” i referohet:

- a) Në rast të korporatës apo kompanisë së krijuar dhe që ekziston me ligjet e Kosovës, bordi i drejtorëve e organizon vetën.
- b) Në rast të një kompanie të huaj të inkuorporuar në juridiksion tjetër, por e cila është e licensuar për t’u marr me biznesin e sigurimeve në Kosovë, zyrtari i lartë i zyrës së kompanisë në Kosovë, i cili është banor i Kosovës dhe i pranuar si i tillë nga BPK-ja.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siç është definuar në këtë rregull.

“Kompania” i referohet njërës apo të dyjave, kompanisë së sigurimeve apo ndërmjetësuesve të sigurimeve.

“Liberalizimi i mbulesës siguroese” nënkupton benefitin e mbulesës siguroese të policës së lëshuar nga kompania e licensuar banorëve të apo riskut të lokalizuar në fushën e tregut, automatikisht I siguron një shumë të sigurimeve e cila është më e madhe se benefiti i mbulesës siguroese të policës apo shumat e detyrueshme minimale të përshkruara në atë fushë tregu për benefitin e mbulesës siguroese të zbatueshme në atë klasë të sigurimit.

“Fusha e tregut” nënkupton një shtet apo territor i cili është i miratuar nga BPK-ja të jetë në listën e Internetit të një kompanie të sigurimit, ku ajo kompani është titullar të ofroj dhe të shes produktet dhe shërbimet e veta.

## **Neni 2** **Shitja Përmes Internetit**

### **1. Sfondi dhe Qëllimi i kësaj Rregulle**

BPK-ja siguron se klientët e produkteve të sigurimit dhe shërbimeve përmes internetit, i ipen mbrojtje e plotë e njejtë sikur klientëve të cilët marrin polica jashtë internetit. BPK-ja e njeh rolin dhe rëndësinë e internetit në zhvelimin e industriës së sigurimeve në

Kosovë dhe lehtësinë e qasjes në klientet e produkteve dhe shërbimeve të sigurimit. Në anën tjetër BPK-ja është e vetëdijshme se aktivitetet e biznesit të udhëhequra përmes internetit ofrojnë mundësi të mashtrimit dhe manipulimeve tjera të dëmshme për klientet dhe industrinë, veqmas nga kompleksiteti i inspektimit dhe mbikëqyrjes së tregut të udhëhequr si dhe aktivitetëve të biznesit të ndodhura në internet. Ky rregull është përshkruar për mbrojtjen e interesit të polisambajtësve dhe për sigurimin e stabilitetit të tregut të sigurimeve në Kosovë dhe në të gjitha juridiksionet në të cilat produktet dhe shërbimet e sigurimit ofrohen dhe shiten përmes internetit.

## **2. Kushtet e Përgjithshme dhe Kërkesat**

Të gjitha kompanitë e sigurimit që ofrojnë dhe shesin produkte dhe shërbime të sigurimit përmes internetit, duhet ta drejtojnë këtë aktivitet të biznesit nën kushtet dhe kërkesat që vijojn:

- a) **Konsistenca.** Aktivitetet e sigurimit në internet janë konsistent me ato aktivite të sigurimit të zbatueshme nëpërmjet mediave tjera të distribuimit të produkteve dhe shërbimeve.
- b) **Transparenca dhe Zbulimi.** Principet dhe standardet e transparencës dhe zbulimit të kërkuara për ofrim dhe shitje të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit jashtë internetit janë të obzervuara dhe të zbatueshme në të gjitha aktivitetet e biznesit të sigurimeve përmes internetit. Kjo nënkupton se:
  1. Nivelin e mbrojtjes së klientit që i ipet klientëve të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit përmes internetit është e njëjtë si për të gjithë klientet e tjerë të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit. Shkalla dhe niveli i mbrojtjes së klientit nuk mvaret nga mediumi i përdorur në distribuimin e produktit.
  2. Ekzistojn informata adekuate për klientin për të marrë një vendim të informuar nëse do të shërbehet ose jo me shërbimet e ofruara në internet.
  3. Interneti nuk përdoret për të bërë krahasimin e shpenzimeve dhe benefittit me bartësit e tjerë të produkteve të sigurimit apo shërbimeve dhe duhet t'i paraqet informatat minimale me sa vijojn:
    - (i) Emrin e plotë, adresën e zyrës qendrore, dhe numrin e telefonit dhe faksit të të siguruarit, dhe nëse është e zbatueshme që ndërmjetësuesi të bëjë ofertën.
    - (ii) Adresën dhe numrat e BPK-së, për të ju referuar asaj si autoritet mbikëqyrës i kompanive të licensuara.
    - (iii) Detalet kontaktuese të të siguruarit, degën apo ndërmjetësuesi dhe autoritetin mbikëqyrës, nëse është ndryshe nga (i) apo (ii).

- (iv) Fushat e tregut apo juridiksionit në të cilin kompania e licensuar është lejuar legalisht që të siguroj produkte të sigurimit dhe shërbime përmes internetit.
  - (v) Procedura e paraqitjes së dëmeve dhe përshkrimi i procedurave të trajtimit të dëmit.
  - (vi) Kontakt informata e personit apo trupi I cili merret me ankesat e klientëve.
- c) Kompania e licensuar i njeh principet të cilat që mbikëqyrja rregulluese është e detyrueshme në koperim me autoritet në juridiksion tjetër. BPK-ja duhet të koproj plotësisht me autoritetet e tjera të mbikqyrjes së sigurimeve në mbikqyrjen dhe rregulluesin e aktiviteteve të sigurimit të drejtuara përmes internetit dhe do t'i jap përkrahje dhe asistencë atyre kur është e nevojshme apo lidhur me rastet e abuzimit të tregut të njëri-tjetrit.
- d) Kompania e sigurimit transakton biznesin e sigurimeve përmes internetit në mënyrë të duhur. Ajo ka sistem të kontrollit adekuat dhe efektiv që përfshinë, menaxhimin e besueshëm të informatës, duke i adresuar qështjet e letrave me vlerë, konfidencialitetin, kontrollin e shënimeve personale, mbështetje dhe sistemin e përshtatshëm të mbajtjes së librave.
- e) Interneti është i lidhur me Webfaqen apo Internet të BPK-së.

### **3. Kërkesat dhe Kushtet Specifike**

- a) Shitja e produkteve dhe shërbimeve të sigurimit, banorve apo riskut të lokalizuar në Kosovë duhet, si shtesë e kërkesave të përshkruara në alinen 1, më lartë, ti udhëheq aktivitetin e biznesit të tij në internet me kushtet dhe kërkesat me sa vijon:
- (i) Para udhëheqjes së çfarëdo biznesi përmes internetit, kompania e licensuar i paraqet BPK-së një kopje të faqes së vetë të internetit dhe faktet apo evidencat e aftësisë së saj për tu përmbajtur alines 1, më lartë. Nëse BPK-ja, nuk e njofton kompaninë për vërejtjet e saja 30 ditë pas datës së kësaj paraqitje, kompania mund të filloj biznesin e vet përmes internetit.
  - (ii) Faqja e internetit të kompanise kjartë indikon se shërbimi është në dispozicion vetëm për banorët apo riskun e lokalizuar në Kosovë.
  - (iii) Nëse faqja e internetit i takon një ndërmjetësuesi, kompania e licensuar e pranon disa përgjegjësi të përbashkëta me

ndërmjetësuesin për cdo përgjegjësi të ngritur jashtë biznesit të udhëhequr përmes internetit.

- b) Para miratimit të BPK-së, duhet të sigurohet para se kompania e licensuar të mund të filloj të ofroj dhe të shes produkte dhe shërbime banorve apo riskut të lokalizuar në juridiksionin jashtë Kosovës. BPK-ja në lirine e saj të veprimit mund ta miratoj aplikimin e kompanisë nëse është e kënaqur me të:
- (i) Kompania paraqet një biznes plan të aresyeshëm lidhur me udhëqjen e biznesit të kompanisë përmes internetit.
  - (ii) Udhëheqja e aktivitetit të biznesit të sigurisë përmes internetit është bërë vetëm përmes ofertës direkte. Kjo nënkupton se aktiviteti nuk mund të udhëhiqet përmes ndërmjetësuesve dhe nuk mund të nënkontarktohet.
  - (iii) Kompania aplikuese mund të pajtohet me kërkesat dhe kushtet e përshkruara në këtë rregull dhe rregullat relevante në juridiksionin e huaj.
  - (iv) Udhëheqja e aktivitetit të sigurimeve përmes internetit është limituar vetëm në fushat e tregut të miratuara nga BPK-ja. Faqja e internetit nuk do të përfshijë asnjë fushë që nuk ka të bëjë me tregun.
  - (v) Shuma e rezervave teknike të kërkuara duhet të jetë më e lartë se shumata e përshkruar në këto rregulla apo shumata e përshkruar nga juridiksioni i huaj i zbatueshëm për klasën apo klasat e sigurimeve të shitura përmes internetit.
  - (vi) Kompania i ofron produktet e veta dhe shërbimet në pajtim me principet e liberalizimit të mbulesës siguroese siq është e definuar në këtë rregull.
  - (vii) Kompania i paraqet autoritetit të mbikëqyrjes suplementare të trupit të regulatorit të sigurimeve në juridiksionin ku udhëheq aktivitetin e biznesit të sigurimeve përmes internetit dhe është në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe rregulloret e përshkruara në atë juridiksion.
  - (viii) Mjetet të cilat kërkohen të mbahen nga kompania për të mbuluar përgjegjësitë e policave të shitura përmes internetit, është mbajtur në Kosovë dhe e investuar vetëm në pajtim me rregullën 12, të investimeve të lejuara.
  - (ix) Kompania duhet të jetë në pajtim me kushtet tjera dhe kërkesat që mund të përshkruhen nga BPK-ja, në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe këtyre rregullave.

### **Neni 3 Pajtueshmëria**

#### **1. Efekti i Mospajtueshmërisë**

Cdo kompani e licensuar e cila udhëheqë biznes të sigurimeve apo aktivitete përmes internetit në pajtim me kushtet dhe kërkesat e përshkruara në këtë rregull mund të jetë subjekt i veprimeve me sa vijon të BPK-së:

- a) Licença e kompanisë mund të suspendohet apo të revokohet dhe BPK-ja, mund të marrë hapa tjerë që mund të jenë të nevojshëm në pajtim me dispozitat e rregullores së sigurimeve dhe këtyre rregullave.
- b) Në lirin e veprimit të vetë BPK-ja ashtu siq mund të ketë mandat nga natyra e mospajtueshmërisë, kompania e licensuar mund të jetë subjekt i kushteve të caktuara të cilat BPK-ja mund ti përshkruaj aresyeshëm në rrethana të dhëna.

### **Neni 4 Hyrja në fuqi**

Ky rregull, do të hyj në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman  
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral